

## E vërteta dhe mediat elektronike lokale

"Mundësitë e vogla për të vetëqëndruar, standarde të vafëra gazetareske dhe menaxhimi, deficite në programim". Këto zbulime publikuar së voni në analizën mbi Mediat Elektronike Vendore nga Misioni i OSBE-së në Kosovë tregojnë një pamje shkatërruese të këtij sektori. Megjithatë, "jo gjithçka është negative", thotë analisti i mediave Eberhard Laue. Raporti është unik në fushën e Zhvillimit të Mediave në Kosovë dhe e menjëherë u bë një mjet i dobishëm dhe strategjik për organizatat ndërkombëtare dhe ato joqeveritare.

**Julius Bott, OSBE**

Dhuna në mars të vitit 2004 ishte destruktive dhe vdekjeprurëse. Kështu, mediat ishin fajësuar shumë për këtë, së paku për përmasat e shpërndarjes së dhunës dhe gjakderdhjes. Ishte identifikuar raportim jo i përgjegjshëm dhe transmetuesit ishin denuar nga Komisioneri i Përkohshëm për Media, si autoritet regullativ për mediat në Kosovë. Megjithatë, raportet e ekspertëve dhe institucioneve treguan gjithashtu se sa pak dihej për mediat vendore.

Prandaj ishin ngritur pyetjet: kush është prapa këtyre radiotelevizioneve vendore? Çfarë ishte programi i tyre? Çfarë ishte situata e tyre financiare? Një pyetsor i përgjithshëm përfshiu rreth 150 tema duke u fokusuar në lirin e mediave dhe qasjen në informata. E para bazohet në supozimin se mediave të lira nuk u mjafton vetëm një ambient i përshatshëm politik. Ato gjithashtu duhet të jenë edhe ekonomikisht të qëndrueshme, në mënyrë që të jenë sa më të pavarura nga ndikimi i jashtëm. I fundit fokusohet mbi qytetarët dhe të drejtat e tyre që të informohen mbi të gjitha ngjarjet dhe proceset në shoqërinë e tyre përkatëse.

Me qëllim të kryerjes së punës sfiduese, çdo stacion televiziv u vizitua nga analisti i mediave Eberhard Laue, i mbështetur nga Shpresa Mulliqi, Donika Shahini, Srdjan Pupovac dhe kolegë të tjerë prej zyrës së



Mediat në Kosovë kanë vështirësi t'i mbulojnë shpenzimet operuese dhe vetëm disa prej tyre mund të pajisen me aparaturë të duhur.

OSBE-së në terren. Gjithashtu, ishin pyetur për ti dhënë mendimet e tyre për këto media edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, administratës komunale dhe një masë e qytetarëve. "Ne dëshiroam të mësojmë për statusin e vërtetë", tha udhëheqësia e Njësisë së Misionit të OSBE-së për Përkrahjen e Mediave, Angela Tenbruk. "Edhe pse në të kaluarën, një numër i ekspertëve vizitoi disa stacione, askush më parë nuk i'a ka dalur të prodhojë një analizë gjithëpërfshirëse për tërë sektorin".

Përgjigjet ishin dekurajuese. "Shumica e radio dhe TV stacioneve nuk veprojnë në pajtim me liçensat e tyre, 61% e transmetuesve janë të paafte t'i mbulojnë shpenzimet përmes të hyrave operative dhe 44% thonë se më tepër se gjysma e punëtorëve të tyre janë ndrruar gjatë 6-12 muajve të fundit", precizon Laue. Dhe ajo që është më e rëndësishmja, audiencia ankohej për kualitetin e pamjaftueshëm dhe cilësinë e lajmeve vendore.

Janë shumë arsye që sollën këtë situatë. Së pari, është një histori shumë e afërt e Kosovës. Disa shqiptarë kosovarë janë punësuar në sektorin e mediave në mes të viteve 1990 dhe 1999. Pas 1999 ky vakum ishte mbushur

shumë shpejt. Disa stacione as që pyetën për leje dhe kur u themelua Komisioneri i Përkohshëm për Media, në qershor të vitit 2000, transmetuesit veqme ishin përhapur.

Gati të gjitha stacionet kishin të njëjtin qëllim: shumica e pronarëve të mediave në anketë kanë thënë se motivimi kryesorë i tyre kur kanë filluar transmetimin është 'informimi i publikut' "Në shumë raste kjo mbeti vetëm dëshirë" thekson Laue. Mëse 79% e pronarëve asnjëherë nuk ishin përfshirë në ndonjë biznes apo në ndonjë përvojë tjetër udhëheqëse. Të mos flasim për menaxhimin e mediave e cila është një çështje krejt tjetër. Dhe 59% asnjëherë nuk kishin punuar në gazetari para se të fillonin në media.

Njohuritë e kufizuar kishin ndikim të madh. "Shumica e stacioneve ëndërrojnë të kenë mbulesë të mirë të Kosovës, duke supozuar se kjo do të jetë më mirë, dhe kështu injorojnë dëgjuesit e tyre dhe dëshirën e tyre për lajme vendore", thotë Laue. Reagimet e qytetarëve janë të një kritike të njëjtë. Për shkak të mungesës së gazetave lokale, TV-të dhe radiot lokale mbesin i vetmi burim i informimit.

### NË KËTË NUMËR

Trajnimi për Gazetarë të radio-televizioneve lokale në Gjilan	pg. 3
Këshilli për Media të Shkruara	pg. 5
Intervistë me Robert Gillete	pg. 6-7
Rrjeti KOSMA	pg. 8
Aktivitete nga zyra e OSBE-së në Lipjan	pg. 11-15

Të nderuar lexues,

Në fillim të vitit 2000, përfaqësuesi i OSBE-së për lirinë e mediave publikoi një studim të Mark Thompsonit për përkrahjen ndërkombëtare të mediave në Ballkanin perëndimor. Pjesa për Kosovën thotë: "UNMIK-u ishte dislokuar në një vakum ligjor dhe informative" dhe "prej vjeshtës [së 1999], skena mediale ishte e ngjeshur, madje shumë e ngarkuar". Në kohën kur kjo analizë ishte duke u përpiluar, kishte vetëm pesë apo gjashtë gazeta ditore, revista të ndryshme, diku rreth 40 radio stacione por pak televizione.

Brenda vitit vijues, mediat elektronike u shtuan, duke arritur mbi 100 në tërë Kosovën. Në aspektin teknik, shtimi i tyre ishte i rastit dhe dukej se shumica, përfshirë edhe donatorët e huaj, ishin më të brengosur se si të transmetonin dicka sesa për përmbajtjen e programit të tyre.

Me kohë mediat transmetuese u liçencuan nga Komisioneri i Përkohshëm për Media. Pak më vonë, botuesit e gazetave kryesore të Kosovës, me përkrahjen e OSBE-së, nënshkruan Kodin për Mediat e Shkruara dhe u pajtuan që të themelojnë Këshillin për Media e Shkruara.

Këta janë vetëm disa nga shumë hapa tjerë përpara, aty ku komuniteti ndërkombëtar dhe mediat e Kosovës kanë punuar së bashku. Janë edhe disa hapa të tjerë të cilët ja-

në përmendur në këtë numër të DETAJE-ve, siç është rrjeti KOSMA, i cili lidh rreth 30 stacione në gjuhën serbe në tërë Kosovën.

Pastaj vie trajnimi. Donatorët ndërkombëtar kanë investuar një shumë të favorshme në zhvillimin profesional të mediave lokale, prej botuesve dhe gazetarëve, deri te menaxherët e marketingut. Trajnime më të specializuara, si Deutsche Welle Akademie, tani janë standard. Çka është më e rëndësishme, OSBE-ja përkrahu themelimin e Institutit për Mediat e Kosovës, i cili do të bëhet një institucion, i formuar nga mediat, për media, për të ofruar trajnime profesionale. Ky institut do të përkrahë kurset e studentëve që do të mbahen nga departamenti i gazetërisë pranë Universitetit të Prishtinës si dhe diplomat pasuniversitare të ofruara nga Instituti Kosovar për Gazetari dhe Komunikim.

Ky numër i DETAJE-ve gjithashtu përmend edhe një mjet pune të dhuruar nga OSBE-ja, udhëzues për media dhe policinë, se si institucioni i të drejtës ligjore dhe institucioni i cili mbron të drejtën e publikut mund të bashkëpunojnë më mirë. OSBE-ja gjithashtu e mbron propozimin e Qeverisë që t'i dekriminalizoj shpifjet, kështu që të çrrënjos 'efektin brengosës', siç e quan përfaqësuesi për lirinë e mediave, duke i'u mundësuar gazetarëve të punojnë në një atmosferë më të lirë.

Sidoçoftë, gjithçka që shkëlqen nuk është

flori, siç e thekson neni i parë. Realiteti është se shumica e mediave nuk janë të qëndrueshme në gjendjen e tyre të tanishme. Mediat do të duhet të shikojnë të gjejnë forma të mbijetesës, ose realiteti ekonomik do t'i largoj ato nga transmetimi. Tregu nuk mund të përballojë numrin aktual të tyre.

Strategjia e mediave për minoritete, e cila ishte miratuar nga Qeveria pak kohë më parë gjatë këtij viti, duhet të bëjë shumë për të bindur se komunitetet jo-shqiptarë kanë qasje në media në gjuhën e tyre, dhe ndihmat financiare do të ipen për të përkrahur zgjerimin dhe qëndrueshmërinë e mediave të minoriteteve.

Sidoçoftë, OSBE-ja nuk do të lërë anash mandatin e vet për zhvillimin e mediave, por zhvillimi themelor është kryer. Institucionet të cilave u ka ndihmuar Misioni që të themelohen, Komisioni i Pavarur për Media, Këshilli i Mediave të Shkruara, Instituti Kosovar për Media do të fillojnë të punojnë vitin e ardhshëm, do të marrin më tepër përgjegjësi si institucione lokale që kujdesen për interesin e mediave të Kosovës.

Ne shpresojmë se ky numër i DETAJE-ve do të jetë interesant për ju, posaçërisht lloji dhe niveli i punës së kryer nga zyra e OSBE-së në Lipjan. Puna jonë ka ndikim në jetën e përditshme të njerëzve.

Sven Lindholm

zëdhënës i misionit të OSBE-së në Kosovë

### vijon nga fq. 1

Edhe nëse stacionet do të zhvilonin koncepte për audiencën e tyre kryesore, shumica prej tyre nuk do të kishin mundësi t'i implemtonin ato. Financat e pamjaftueshme ndikojnë edhe në cilësinë e personelin. Si pasojë shumë stacione i reduktojnë programimin e tyre dhe e kthejnë në transmetim të muzikës ku transmetohet muzikë për plotësimin e dëshirave dhe urimeve të parapaguesve. Lajmet shumë shpesh ritransmetohen nga stacionet siç janë 'Deutsche Welle,' 'BBC' apo 'Zëri i Amerikës'. Mëse 61% e pronarëve duhet të kontribuojnë më paratë e tyre apo të mbështeten nga të ardhurat e familjeve të tyre jashtë vendi, në donatorët apo KFOR-in, thekson raporti. Këta, me kontratat e tyre për blerjen afatgjatë të kohës së transmetimit janë bërë përkrahësit më të rëndësishëm të transmetuesve.

"Është me rëndësi të kuptohet se, interesimi i KFOR-it koncentrohet në një qasje të pakushtëzuar në thelbin e programeve dhe porosive të transmetuesve", shpjegon Laue. "Kjo qasje nuk duhet të ngatërrohet me OSBE-në dhe tendencat tjera të organizatës për zhvillim të mediave." Sidoçoftë, raporti dhe prezantimi i tij inicio një dialog në mes OSBE-së dhe KFOR. Një forum me akterët kryesorë është planifikuar për dhjetor.

Paraqitja e raportit kishte një ndikim të ngjashëm, sa i përket akterëve tjerë. Përgjegjëjet të renditura prej 'punë e shkëlqyeshme' dhe 'ju konfirmuat atë që ne gjithmonë e kemi menduar, por asnjëherë nuk mundëm ta dëshmonim', deri te "një mjet shumë i

çmuar për strategjinë tonë të zhvillimit në të ardhmen." Në disa raste analizat patën një ndikim të drejtpërdrejt në aktivitetet në zhvillim e sipër. Misioni i OSBE-së është duke i shfrytëzuar rezultatet për të përshtatur strategjinë e vetë në përkrahje të themeimit të një sektori më të qëndrueshëm dhe më kualitativ.

Megjithatë, jo të gjitha përfundimet ishin negative. Ende ekziston një numër i vogël i stacioneve me kuptim të mirë të asaj çfarë audiencia pret dhe çfarë roli mund të luajn mediat në një shoqëri demokratike. Radio Kontakt Plus-i në veri të Mitrovicës, p.sh. është çmuar lart për lajmet e veta dhe programin informativ. Radio Tema në Ferizaj dhe Radio Dodona në Glogoc kanë zhvilluar koncepte të efektshme për mirëmbajtjen e mardhënieve të mira në mes të radiostacioneve të tyre dhe audiencës.

Një numër tjetër i mediave mund të merren si shembuj për të gjitha praktikat e tyre positive megjithatë, një radio stacion e tërheq vëmendjen me thjeshtësinë e lajmeve të tyre. Radio Restelica, e stacionuar në një fshat të vetmuar lart në male, për shkak të mungesës së teknologjisë tjetër për komunikim është stacion në shërbim të komunitetit. Nëse ju duhet një mjek, ndihma e tij kërkohet përmes radios. Nëse ndodh ndonjë aksident, njerëzit mobilizohen përmes radios. Gjithashtu, nëse dikush martohet kjo ngjarje lajmohet në radio se i tërë fshati mund të festoj. Vetëm në raste të vdekjes, është ndryshe: pronari e ndal transmetimin, dhe edhe këtë gjithkush e kupton.

## DETAJE

Gazetë e publikuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë

OSCE HQ, Prishtinë / Priština, Kosovo  
Tel: +381 38 500 162, Fax: +381 38 500 188  
E-mail: [press.omik@osce.org](mailto:press.omik@osce.org)  
Web site: [www.osce.org/kosovo](http://www.osce.org/kosovo)

Botuesi:

Sven Lindholm

Kryeredaktor:

Nikola Gaon

Redaktorë:

Hasan Sopa, Armend Tahirsylaj (Detaje)

Slaviša Mladenović (Detalji)

Faqosja:

Shpend Kada

Bashkëpunorët:

Julius Bott, Radka Betcheva, Mevlyde Salihu, Lizabeta Paloka, Chris Cymmanik, Arben Hajredinaj, Edita Buçaj, Edit Kovacs, Luras Oseku, Vardon Hoxha, Mirdita Retkoceri, Berat Reçica, Predrag Rasić, Vladan Trifić, Danijela Mitić, Mustafa Skenderi

**osce**

Mission in Kosovo

Shënim:

Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politikën, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.



# Gazetarëve të Televizionit në Gjilan u ofrohet mbështetje

Radka Betcheva, OSBE

Të injoruar për nga rëndësia e tyre, mediat lokale të informimit, duke përfshirë këtu radiostacionet rurale por edhe buletinet informative periferike, janë burim kryesor informimi për shumicën e qytetarëve. Bazuar në shkallën e besueshmerisë në fusha të caktuar, gazetarët lokal mund të ofrojnë informata që u përgjigjen kërkesave të një komunitetit apo audience gjeografike. Përshatja e raporteve për çështjet lokale me lajme relevante me karakter kombëtar si dhe storjet me origjinë lokale kanë një ndikim të rëndësishëm në opinionin publik regjional por edhe për publikun e gjërë në tërësi.

Me raportim të paanshën dhe kualitativ mediat lokale mund të ndihmojnë që udhëheqësit komunal por edhe ata të komunitetit të jenë më përgjegjës në marrjen e vendimeve të tyre dhe në përgjithësi mund të ushtrojnë ndikim në proceset demokratike dhe të pajtimit ndëretnik. Mediat lokale janë veçanërisht të rëndësishme gjatë perudhës së tranzicionit, si kjo nëpër të cilën po kalon Kosova, ku mundësitë e mediave për t'i motivuar dhe involvuar njerëzit në mënyrë aktive në proceset shoqërore, siç është edhe implementimi i standardeve për Kosovën, është esenciale.

Në Gjilan OSBE-ja është duke punuar në ngritjen e aftësive profesionale të gazetarëve të televizionit. Misioni i OSBE-së duke u

përpjekur të siguroj që media të funksionojnë në bazë të standardeve të respektuara gazetareske, ka qëllim primar përmirësimin e mënyrës së raportimit për çështjet lokale dhe ngritjen në një nivel më të lartë të profesionalizmit, besueshmerisë dhe përgjegjësisë ndaj shikuesve.

Gjatë muajit korrik dhe stator, zyra e OSBE-së ka zgjedhur shtëmbëdhjet gazetarë entuziast të televizioneve lokale nga regjioni i Gjilanit për të marrë pjesë në dy punëtori të ofruara nga trajner të 'Deutsche Welle Akademie' – Qendra Ndërkombëtare për Trajnimin e Gazetarëve. Temat për të cilat u diskutua ishin përgaditja e lajmeve dhe reportazheve si dhe raportimi i tyre.

Gazetarët që punojnë për televizionet lokale të Kosovës në gjuhën shqipe dhe serbe, udhëheqëshin nga trajnerë të Akademisë me qëllim që ata t'i përmirësojnë mënyrat e raportimit për çështjet politike, ekonomike dhe sociale. Tregimet e tyre janë diskutuar në mënyrë të detajuar dhe janë analizuar si nga pjesëmarrësit ashtu edhe nga trajnerët. Këshilla dhe rekomandime praktike janë ofruar nga trajnerët, por gjithashtu u prezantuan edhe shembuj hulumtues dhe shkrime nga Gjermania dhe vende të tjera. "Ajo që më pëlqen nga këto punëtori është se kemi qenë shumë konkret, veçanërisht pjesa praktike",

shprehet pas sesionit të parë Vjosë Kryeziu, një gazetarë në TV VALI.

Gjatë sesionit për përgaditjen e dokumentarëve dhe raportimin e tyre u shfaqën shembuj të përgaditur nga vetë pjesëmarrësit që ishin nga komunitete të ndryshme të Kosovës shqiptar, serb, dhe rom. Një dokumentar për luftën e vitit 1999, i përgaditur nga një stacion televiziv në gjuhën shqipe nxiti diskutime për mënyrën e raportimit në periudhën e pas konfliktit.

"Për mua diskutimi 'teoria me pesë fotografi', ndoshta ka qenë pjesa më interesante e punëtorisë", u shpreh Gyner Muja, një kameraman i TV MËN-it. "Gjatë ushtrimeve unë kam mësuar të bëjë fotografi të përshatshme në mënyrë që të transmetoj mesazhin tek shikuesit përmes fotografisë".

Të dy trajnimet u mirëpritën mjaftë mirë nga pjesëmarrësit të cilët pajtoheshin se njohuritë e përfituara gjatë këtyre dy ditëve ishin mjaftë të dobishme për punën e tyre profesionale. Nenad Nasković, nga TV ZOOM-i, ka qenë veçanërisht i entuziazmuar pas sesionit të fundit: "Unë mendoj se kjo na ka ndihmuar shumë në ngritjen e njohurive dhe shkatësive tona. Në të ardhmën këto njohuri do të më shërbejnë në punën time, për t'u ballafaquar me situata të vështira që mund t'i has".



Trainimi për përgaditjen e lajmeve dhe reportazheve që u është ofruar disa gazetarëve të radiotelevizioneve në regjionin e Gjilanit gjatë muajve gusht dhe shtator 2005, përfshinin edhe një numër aktivitësh praktike.

# Dekriminalizimi i shpifjes dhe fyerjes

Mevlyde Salihu, OSBE

Një delegacion i Kosovës, i përbërë nga katër anëtarë të Komisionit të Kuvendit të Kosovës për Media dhe dy këshilltarë të Kryeministrit, udhëtoi në Strazburg, Francë, më 12 tetor 2005, që të marrë pjesë në një takim ekspertësh, i cili ishte organizuar nga Këshilli Evropian, për të shqyrtuar Draftligjin e Kosovës për shpifje dhe fyerje.

Ky Draftligj, i përpiluar dy muaj më parë nga zyra ligjore e Kryeministrit të Kosovës në bashkëpunim me ekspertë vendor dhe ndërkombëtar, si dhe me ndihmën e OSBE-së dhe Komisionerit të Përkohshëm për Media, do t'i dorëzohet Kuvendit për miratim. Menjëherë pas miratimit, ai do të dekriminalizojë shpifjen dhe fyerjen.

Kjo d.m.th. se paditë për shpifje dhe fyerje të ngritura në Kosovë nuk do të trajtohen më si vepër penal, por sipas Ligjit Civil. Rastet e vërtetuara për shpifje nuk do të denohen me burg, por ato do të denohen me gjoja dhe denime tjera që mund të përfshinë botimin e kërkimfaljeve publike dhe reagimeve.

Në Kosovë janë shënuar disa raste kur gazetarët janë dënuar me burg për shkak të ndonjë fyerje apo shpifje. Raste të tilla datojnë që nga koha para konfliktit dhe pas vitit 1999.

“Në qershor të vitit 2004, një korrespondent nga Prizreni ishte dënuar me burg

pastaj ishte liruar me kusht. Pasi që Ligji për Shpifje dhe Fyerje është ende pjesë e Ligjit Penal, nëse këta gazetarë denohen sërish në të ardhmën e aftërt, ata do të duhet ta vuajnë denimin për disa kohë në burg” tha Shpresa Mulliqi, zyrtare e departamentit të demokratizimit pranë OSBE-së. “Prandaj, heqja e legjislacionit për shpifje nga Ligji Penal i Kosovës dhe përfshirja e tij në Ligjin Civil është e një rëndësie dhe urgjence të jashtëzakonshme”, shtoi ajo.

Takimi i Ekspertëve në Strazburg u shfrytëzua për të shqyrtuar Draftligjin dhe për të inkorporuar ekspertizat e Këshillit të Evropës, si dhe për të fituar më shumë mbështetje nga ligjvënësit për dekriminalizimin e procesit të shpifjes.

Pjesëmarrësit e takimit të Strazburgut pajtohen tani dhe shpresojnë se Draftligji do të miratohet së shpejti dhe se shpifja dhe fyerja do të dekriminalizohen së shpejti. Megjithatë, qarku zhvillues për ligje ka një numër fazash. Draftligjet duhet të shkojnë nëpër një numër të konsiderueshëm shqyrtimesh, dhe se ai që ka ndodhur tani së fundi në Strazburg me siguri se nuk është i fundit.

Draftligji i tanishëm për shpifje dhe fyerje bazohet në një numër të ligjeve të ngjashme të zhvilluara në Evropën Juglindore.

Mirëpo, ai i është përshtatur kushteve në Kosovë. “Përshtatjet janë bërë për të siguruar se ligji korrespondon me mentalitetin dhe kulturën kosovare, si dhe vetitë që karakterizojnë popullin tonë,” tha Mulliqi. Ajo shtoi, “Ndryshimet, për të cilat është arritur marrëveshje në Strazburg, do të përfshihen tani në draft”.

Ashtu siç është tani, draftligji duhet të vendoset para një dëgjimi publik që mund të rezultojë me korrigjime të tjera. Pas dëgjimit publik, Draftligji do të shkojë nëpër procedurë për miratim në Kuvend. Pastaj, para se të hyjë në fuqi, ai do t'i dërgohet Këshillit të Evropës si dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të siguruar se ai mbështet parimet e të drejtave të njeriut dhe se është në përputhje me ligjet e tjera të aplikueshme në Evropë.

Në ndërkohë, mediat Kosovare nuk do të bëjnë përjashtime kur jemi tek thyerja e kodit të mirësjelljes së mediave. “Kemi media në Kosovë të cilat shpesh deformojnë faktet dhe manipulojnë me të vërtetën. Këto zhvillime mund të klasifikohen ose si fyerje apo shpifje,” shpjegon Mulliqi.

Megjithatë, është vendimtare që kur gazetarët shkruajnë tregimet e tyre, ata nuk duhet të frikësohen nga burgju. Deri sa artikujt e padrejt dhe të pakonfirmuar, të cilët shkruhen apo transmetohen, shpesh janë kundër figurave politike, në demokraci është shumë e rëndësishme që këto figura nuk mund të përdorin instrumentin e burgosjes që të frikësojnë gazetarët dhe të diskurajojnë ata që të mos publikojnë çështje të ndijeshme, siç janë korrupsioni, ose praktikat e tjera të papranueshme shoqërore.

Që nga viti 1999, të gjitha ankesat që kanë të bëjnë me sjelljen e mediave janë gjykuar në shkallën e parë nga Komisioneri i Përkohshëm për Media. Ka pasur raste kur mediat janë përballur kryesisht me gjoja të larta. Megjithatë, personat që nuk janë të kënaqur me vendimin e Komisionerit mund të shkojnë në gjykata komunale dhe ngrisin padi sipas Ligjit Penal. Rasti më i mirë është ai i korrespondentit nga Prizreni.

Kur fuqizohet Ligji, ai do të rregullojë ankesat për shpifje dhe fyerje sipas Ligjit Civil dhe ata që shkelin ligjin do të gjobiten, por nuk do të burgosen. Me qëllim që të mbështesë Ligjin, Këshilli për Media dhe Komisioni i Pavarur për Media, të dyja të themeluara me ndihmën e OSBE-së, do të shërbejnë si organe vetërregullative dhe rregullative për mediat e shkruara dhe transmetuese.



Delegacioni Kosovar i përbërë nga katër anëtarë të Komitetit për Media i Kuvendit të Kosovës dhe dy këshilltarë ligjor (nga e majta në të djathtë), të shoqëruar nga Komisioneri i Përkohshëm për Media, Bob Gillette (në mes), morën pjesë në takimin e organizuar nga Këshilli i Evropës më 12 tetor 2005, për të diskutuar rreth Draftligjit për shpifje dhe fyerje.



# Shtypi kosovar rregullon veten përmes Këshillit për Media të Shkruara

Gazetarët shpesh herë thonë se lajmi i dhënë në agim nuk është më lajm në perëndim. Me qëllim që të ruhet intenziviteti i qarkullimit të lajmeve, gazetarët nga e tërë bota vazhdimisht kërkojnë lajme dhe tregime të reja. Duke bërë këtë, ata nganjëherë nuk sillen në bazë të Kodit të Mirësjelljes për Shtyp. Prandaj, ka nevojë për monitorim të mediave dhe intervenime korrigjuese. Këto zakonisht bëhen përmes mekanizmave vetërregullues të mediave.

Lizabeta Paloka, OSBE

Pas përfundimit të konfliktit më 1999, puna e mediave lokale nuk ishte rregulluar nga asnjë institucion vendor. Prandaj, me qëllim që të përmirësojë këtë gjendje, Misioni i OSBE-së, shtylla e administratës së përkohshme të KB-së për ngritjen e institucioneve, themeloi zyrën e Komisionerit të Përkohshëm për Media. Në atë kohë, detyrë e kësaj zyre ishte që të rregullojë punën e mediave të shkruara dhe atyre elektronike. Sikurse edhe emri i tij, edhe ky institucion është i përkohshëm. Një zgjidhje afatgjate për rregullimin e punës së mediave gjendet në themelimin e organeve vendore rregullative.

## Themelohet Këshilli për Media të Shkruara

Një organ i tillë u themelua gjatë kësaj vere. Këshilli për Media të Shkruara, siç quhet tani, është një asociacion i mediave të shkruara dhe si i tillë shërben si organ vetërregullues. Detyrë kryesore e Këshillit është që të monitorojë sjelljen e mediave të shkruara dhe të sigurojë se ato i përmbahen parimeve të theksuara në kodin e mirësjelljes, që u aprovua nga të gjithë akterët e mediave në pranverë të këtij viti. Për t'u bërë anëtarë të këtij Këshilli, mediat duhet që të nënshkruajnë Kodin si dhe Statutin e Këshillit.

Anëtarët e Këshillit, që përfaqësojnë gazetat kryesore të Kosovës, e kanë fuqizuar atë me fuqi dhe autoritet të konsiderueshëm. Për shembull, Këshilli mund të sanksionojë mediat me gjoba apo t'i udhëzojë ato që të botojnë dënimin e tyre.

## Kontribut për lirinë e të shprehurit

Megjithatë, anëtarët e tij nuk e shohin Këshillin si një organ që duhet të shtyp mediat. Ata e shohin atë si një organ që duhet t'i kontribuojë lirisë së të shprehurit dhe vetërregullimit. Predrag Radonjiq, zëvendës drejtor i Bordit të Këshillit, thotë se Këshilli mund të funksionojë në mënyrë të duhur vetëm nëse të gjitha mediat e involvuara vullnetarisht janë të kujdesshme për të mos imponuar masa kufizuese.

Kolegu i tij, Gani Mehmetaj, drejtor ekzekutiv i gazetës ditore Bota Sot si dhe anëtar i bordit thotë se Këshilli për Media të Shkruara duhet të marrë rolin e gjykatave për të qenë trup i shakllës së parë në adresimin e rasteve të shkeljeve të kodit të mirësjelljes nga mediat. "Arsyeja e parë për çka edhe

Këshilli është krijuar ishte që t'i zgjidhë rastet diskutabile para se ato të kanë nevojë të dërgohen në gjyq", thotë ai. "Në këtë mënyrë liria a shprehjes nuk do të ngulfatej dhe në të njëjtën kohë gazetaret nuk do të përdroreshin nga partitë politike si fushëbetejë apo mekanizma për zgjidhjen e problemeve.

## Struktura e Këshillit

Tash Këshilli e udhëheq punën e tij përmes Bordit të Anëtarëve dhe Sekretariatit. Bordi ka për detyrë shqyrtimin dhe gjykimin e çdo rasti potencial të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes nga mediat e shkruara. Anëtarët e tij janë kryeredaktorë, apo përfaqësues të të gjitha gazetave të botuara në gjuhën shqipe, serbe, turke apo boshnjake si dhe tre anëtarë që nuk kanë lidhje me media dhe anëtarë të pavarur të nominuar dhe zgjedhur nga shumica e votave të anëtarëve të Bordit. Sekretariati, është aty që të përkrahë punën e Bordit.

## Këshilli për Media të Shkruara për banorët e Kosovës

Këshilli për Media të Shkruara është trup vetërregullativ i mediave të shkruara të Kosovës. Ai monitoron sjelljen e mediave

dhe reagon sipas nevojës, por gjithashtu është i hapur edhe për pranimin e ankesave. Çdo person që konsideron se një media e caktuar i ka shkaktuar dëm, ka të drejtë të ankohet në këshill (adresa e emailit: [presscouncil.kosovo@gmail.com](mailto:presscouncil.kosovo@gmail.com)). Bordi do ta shqyrtojë ankesën dhe do të vendosë për vlershmërinë e tij. Nëse media deklarohet fajtores për shkelje, Bordi do ta dënojë dhe do të ndërmerr masën e duhur.

Fondet e mbledhura nga gjocat e mediave do të përdoren për operacionet e Këshillit si dhe për t'ua kompensuar dëmin e shkaktuar individëve të caktuar.

## Roli i OSBE-së

Me qëllim që Këshilli ta fillojë punën menjëherë, Misioni i OSBE-së i ka siguruar atij mjete të nevojshme materiale, gjerisa donatorët tjerë të mediave kanë premtuar gjithashtu mbështetjen e tyre.

Duke u orvatur të promovojë dhe sigurojë standardet më të larta të gazetarisë në Kosovë, përveç mbështetjes së ofruar me formimin e Këshillit për Media të Shkruara, OSBE-ja do të vazhdojë të monitorojë dhe mbështesë punën e këtij këshilli së bashku me institucionet tjera monitoruese në Kosovë.



Pjesa më e madhe e mediave të shkruara marrin pjesë në punën e Këshillit për Media të Shkruara.

# Profesionalizmi dhe paanësia në mesin e mediave të Kosovës hyjnë në një fazë të re

Robert Gillette, një gazetar amerikan, arriti në Kosovë vetëm para dy vitesh për të shërbyer si Komisioner i Përkohshëm për Media (KPM). Tani, ky institucion, përgjegjës për përkrahjen e standardeve etike dhe teknike në mesin e mediave të Kosovës, fillon një fazë të re.

Chris Cycmanick, OSBE

Zyra e KPM-së, fillimisht e themeluar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë sipas rregullores 2000/37, aktualisht është duke u përgatitur që të bëhet Komisioni i Pavarur për Media (KPM).

Si rezultat i tranzicionit, Komisioni i Përkohshëm për Media do të transferojë përgjegjësitë e tij për rregullimin e transmetuesve elektronik tek Komisioni i Pavarur për Media dhe detyrat e tij për përkrahjen e etikës në gazetarinë e shkruar do të transferohen tek Këshilli për Media të Shkruara.

Këto institucione të pavarura pritet që të vazhdojnë punën mbi traditën e KPM-së për promovimin e standardeve profesionale të profesionalizmit dhe paanësisë në mesin e mediave të Kosovës. Suksesi i tyre do të jetë esencial për demokracinë vetëqeverisëse të Kosovës dhe për ruajtjen e një shoqërie të lirë e të hapur.

Robert Gillette bisedon gjatë me "Detajet" lidhur me pozitën e tij si Komisioner i Përkohshëm për Media dhe për sfidat që e presin Komisionin e Pavarur për Media.

**Detaje: Gjatë dy e më shumë viteve si Komisioner i Përkohshëm për media, cila ka qenë sfida më e madhe me të cilën është përballë zyra juaj?**

**Gillette:** Ka qenë e qartë që nga fillimi, në verën e vitit 2003, se sfida jonë më e madhe do të ishte ta bindim OSBE-në dhe UNMIK-un që ndërtimi i një trupi rregullator vërtetë të pavarur, funksional dhe profesional kërkonte që stafi i tij të mos përfshijë nëpunës qeveritarë dhe që ata të jenë të liruar nga shërbimi civil, ashtu sikur që janë rregullatorët e mediave elektronike në pjesën më të madhe të Evropës. Fatkeqësisht, ky realitet bie në konflikt me një politikë jofleksibile të UNMIK-ut. Kështu që gati 30 muaj më vonë, sfida jonë më e madhe nga viti 2003 akoma mbetet sfida jonë më e madhe.

**Detaje: Çfarë konsideroni si arritjen më të rëndësishme gjatë kohës suaj si KPM?**

**Gillette:** Përkundër vështirësive reale më të cilat jemi përballë, kolegët e mi, Gian Pietro Caliani dhe Charles Ehrlich dhe unë, kemi qenë me fat të ndërtojmë një ekip të vogël me staf të shkëlqyeshëm kosovarë, të cilët, nëse sfida jonë më e madhe tejkalohet, do të formojnë një rregullator tërësisht profesional dhe të qëndrueshëm mbi mediat elektronike. Ne poashtu kemi gjetur partnerë të mirë pune në zyrën e Kryeministrit dhe në

Kuvend për të zhvilluar një komplet të tërë të legjislacionit mbi media që i plotëson standartet evropiane. Këtu përfshihen ligji mbi Komisionin e Pavarur për Media, draft ligji mbi transmetuesit publik i cili tani është në Kuvend, dhe një draft ligj civil mbi shpifjen i cili është duke u kompletuar tani.

Ne punuam me RTK-në dhe KEK-un për të vendosur një tarifë të suksesshme për transmetuesin publik e cila do t'i sillte RTK-së një pavarësi të plotë financiare deri në fund të vitit të ardhshëm. Këtë vit ne me sukses kemi prezentuar një formë të re dhe më profesionale të licencimit e cila qartëson rregullat e operimit për të gjitha stacionet televizive dhe radiot, dhe e cila vendos kërkesat dhe kushtet specifike teknike për secilin transmetues. Kjo licencë e re është pranuar mirë nga të gjithë transmetuesit në Kosovë, dhe ne e çmojmë bashkëpunimin e tyre.

Në fund, me krijimin e Këshilli për Media të Shkruara, ne kemi qenë në gjendje t'i japim fund rregullores sonë mbi mediat e shkruara që nga shtatori, kështu që ne do të mund të koncentrohemi në fazën e fundit të tranzicionit në Komisionin e Pavarur për Media.

Ajo çfarë e gjithë kjo nënkupton është se shumica e standardeve kryesore për mediat në Kosovë tani veç janë përmbushur, apo do të përmbushen gjatë disa muajve të ardhshëm.

**Detaje: Sa mendoni se publiku në përgjithësi është i informuar për rolin e Komisionerit të Përkohshëm për Media?**

**Gillette:** Me gjasë jo shumë, dhe sigurisht jo aq shumë sa publiku do të ishte dashur të di. Forma më efektive e 'monitorimit' të transmetuesve dhe zbatimit të kodit të etikës është përmes ankesave nga një publik i informuar i cili e di se cilat janë kërkesat etike themelore të transmetuesve, dhe i cili e di se dorëzimi i një ankese valide tek rregullatori do të sjell rezultate. Kjo kërkon një përpjekje për edukim sistematik dhe të qëndrueshëm të publikut nga ana e rregullatorit gjatë një periudhe disa vjeçare. Zyra e KPM-së nuk e ka bërë këtë. Shpresoj që zyra e Komisionit të Pavarur për Media do ta bëjë.

**Detaje: A është themeluar ende Këshilli për Media të Shkruara, si trup përgjegjës për përkrahjen e etikës në gazetarinë e shkruar? Si mendoni se do të funksionojë ky Këshill në planin afatgjatë?**

**Gillette:** OSBE-ja ka marrë rolin prijës në punën me mediat e shkruara të Kosovës për të themeluar Këshilli për Media të Shkruara, dhe ai është duke u zhvilluar mjaft mirë sa që ne kemi qenë në gjendje ta përfundojmë rolin tonë në rregullimin e mediave të shkruara. Këshilli për Media të Shkruara akoma nuk ka filluar të merrret me ankesa, por ai do të fillojë shumë shpejt. Këshilli për Media të Shkruara përbëhet nga të gjitha gazetaret ditore dhe revistat javore të Kosovës. Ato garojnë me njëra tjetrën, por e kuptojnë se ato kanë një interes të përbashkët që të trajtojnë më me efikasitet dhe në mënyrë të paanshme ankesat nga publiku, për ta ruajtur dhe ndërtuar kredibilitetin e tyre, dhe për të zvogëluar rrezikun për t'u marrë me ankesa në formë të proceseve gjyqësore në gjykatë. Kjo nuk do të jetë e lehtë. Këshilli për Media të Shkruara do t'i duhet të gjejë një mekanizëm për të trajtuar ankesat i cili nuk shpie në mosmarrveshje të brendshme në mesin e anëtarëve të tij, gjë e cila do të ishte fatale për Këshillin.

**Detaje: Cila është ndarja e përafërt (në përqindje) e ankesave të pranuar kundër mediave të shkruara dhe elektronike? Të çfarë natyre ishin pjesa më e madhe e ankesave më të rënda?**

**Gillette:** Pjesa më e madhe e ankesave të cilat i kemi pranuar gjatë pesë viteve të kaluara, më shumë se 90% e tyre, ndërlihdhen me mediat e shkruara. Shumica e këtyre ankesave lindën kur një gazetë dështoi t'i japë një personi, zakonisht një figure publike, një rast të drejtë për t'ju përgjigjur akuzave kundër atij personi. Rastet më të rënda në ditët e para të KPM-së ndërlihdeshin me përpjekjet e qëllimshme nga gazeta të caktuara, të cilat nuk botohen më, për të provokuar sulme kundër individëve të caktuar. Fatmirësisht, ne nuk e shohim më këtë lloj sjelljeje të rrezikshme. Rastet më të rënda gjatë dy viteve të fundit kanë pasur të bëjnë me sjelljen e mediave të caktuara në marsin 2004, dhe shkeljet nga dy gazeta të rregulloreve të zgjedhjeve mbi media në vjeshtën e vitit 2004.

Këto dy raste kanë qenë përjashtim nga struktura e përgjithshme gjatë fushtës së kaluar zgjedhore, në të cilën pothuajse të gjitha mediat punuan në mënyrë profesionale. Këto dy gazeta akoma nuk kanë paguar gjokat të cilat u janë vënë. Ne jemi duke ndërmarrë veprime ligjore për të mbledhur ato gjoka.





Komesioneri i Përkohshëm për Media, Robert Gillette, filloj detyrën e tij në verë të vitit 2003. Ai është Komesioneri i katërt dhe ndoshta i fundit në këtë post. Këshilli për Media të Pavarura dhe Këshillit për Media të Shkruara, duhet të marrin përgjegjësinë përkatëse të zyrës së tij në fillim të vitit 2006.

**Detaje:** A janë lëshuar licenca të reja këtë vit? Nëse po, cilat kanë qenë kriteret kryesore që janë përdorur në vlerësimin e aplikacioneve?

**Gillette:** Në dhjetor të vitit 2003, ne bëmë një përjashtim të kufizuar në moratoriumin tonë të përgjithshëm mbi licencat e reja. Ne pranuan aplikacione për transmetuesë shumetnik dhe për minoritete, apo për transmetuesë për të shërbyer në zonat të cilat në atë moment nuk kishin asnjë media lokale. Ne kemi lëshuar shtatë licenca të reja sipas kësaj politike deri me tani, dhe me gjasë do të lëshojmë edhe dy apo tri më së shumti, aty ku ekziston nevoja reale dhe në rastin kur aplikanti tregon premtim real për profesionalizëm dhe aftësi për ta udhëhequr dhe financuar një stacion të ri.

**Detaje:** Në vitin 2001, janë lëshuar shtatë licenca që kanë mbuluar tërë territorin e Kosovës, megjithatë, që nga atëherë nuk janë lëshuar licenca të tilla. A dini për ndonjë plan të Komisionit të Pavarur për Media për të lëshuar licenca shtesë mbarë Kosovare?

**Gillette:** Po, ne kemi një transmetues televiziv publik dhe dy televizione komerciale mbarë kosovare (RTK, TV 21 dhe KTV), dhe dy radio stacione publike dhe dy radio stacione komerciale mbarë kosovare (Radio Kosova dhe Radio Blue Sky, të cilat janë pjesë e RTK-së, dhe Radio 21 dhe Radio Dukagjini.) Secili prej këtyre transmetuesëve kërkon një numër të frekuencave të ndryshme, që operojnë në lokacione të ndryshme rreth Kosovës, me qëllim që të mbulohet i tërë territori. Përveç kësaj, Kosova ka më shumë se 100 transmetuesë tjerë lokal. Si rezultat, spektri i frekuencave në Kosovë, që nuk është një vend i madh, është mjaft i mbushur. Ne dyshojmë që ka vend edhe për ndonjë transmetues tjetër mbarë kosovarë. Edhe po të kishte ende hapësirë në spektrin e frekuencave, rregullatori i transmetuesëve duhet të marrë parasysh nëse tregu i reklamave në këtë ekonomi të dobët do të ishte i mjaftueshëm për të mbështetur një televizion të katërt. Televizioni është i shtrenjtë. Lejimi i shumë transmetuesëve që të hanë në të njëjtën pjatë të vogël, rrezikon që të gjithë ata të ushqehen keq. Sidoqoftë, ne nuk mund t'i dimë planet e Komisionit të Pavarur për Media derisa të emërohet Këshilli drejtues i Komisionit të Pavarur, në pjesën më të madhe nga Kuvendi. Ne shpresojmë që ky proces do të përfundohet nga fundi i këtij viti. Pastaj Komisioneri i Përkohshëm për Media mbetet histori ndërsa Komisioni i Pavarur bëhet rregullatori i përhershëm për transmetuesë në Kosovë

**Detaje:** Cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

**Gillette:** Do të mendojë për këtë kur të arrij tek e ardhmja.

# Instituti i mediave të Kosovës

“Instituti i medias të Kosovës”  
paras  
do të kontribuojë në kr  
b

. Ky institucion edukativ

Arben Hajredinaj, OSBE



Memorandumi i mirëkuptimit në mes të Institutit të Medias të Kosovës, Shkollës Daneze për Gazetari dhe Misionit të OSBE-së, me rastin e themelimit të Institutit të nënshkruar në shtator 2005 në Prishtinë.

## Ndryshimi i qasjes

Gjatë pesë viteve të fundit, Misioni i OSBE-së ka implementuar programe trajnimi për media në të mirë të gazetarëve aktivë në Kosovë. Megjithatë, së shpejti Misioni do t'i ndërpresë aktivitetet e tij në këtë lëmi. Në vend që të ofrojë dhe mbështesë seri trajnimesh, Misioni i OSBE-së tani do të mbështesë punën e institucionit edukativ të gazetarëve në Kosovë, Institutin e Medias në Kosovë.

## Historia e institutit

Në mars të vitit 2004, OSBE-ja ftoi Shkollën Daneze për Gazetari që të vlerësojë mundësinë e themelimit të një instituti që kryen trajnimin e gazetarëve gjatë karrierës së tyre. Danezët, së bashku me përfaqësues të Institutit Shqiptar të Medias dhe Institutit për Shoqëri të Hapur mbajtën një sërë takimesh me mediat kryesore dhe përfaqësuesit e komunitetit të donatorëve. Rezultatet e tyre treguan që mediat e Kosovës dëshirojnë dhe kanë nevojë për edukim të mëtutjeshëm dhe që donatorët ishin të gatshëm ta mbështesin një projekt të tillë.

Për të inicuar procesin e themelimit të Institutit të Medias të Kosovës (IMK), OSBE-ja vendosi të mbështesë ekipin e IMK-së, të përbërë fillimisht me nga një përfaqësues prej Shkollës Daneze të Gazetarisë, Institutit Shqiptar të Medias si dhe nga Qendra për Profesionalizimin e Medias me seli në Beograd me qëllim të themelimit të një Grupi të kompletuar punues. Grupi Punues i cili pas themelimit përfshiu përfaqësues të medias nga tërë rajonet e Kosovës, i'u delegua detyra për të krijuar një platformë dhe për të

siguruar kushtet për themelimin e institutit. Brengat e tyre primare ishin kualiteti i trajnimeve në të ardhmen si dhe qëndrueshmëria financiare.

## Qëllimet e vendosura

Grupi punues zhvilloi konceptin e IMK-së. Përmes një konsensusi, ata u pajtuan që instituti duhet të përkrahë ngritjen e aftësive profesionale, standardeve dhe etikës si dhe zhvillimit të medias së pavarur, të lirë dhe pluraliste në Kosovë. Instituti gjithashtu duhet të përkrahë pjesëmarrjen e medias dhe gazetarëve të Kosovës në asociacionet dhe ngjarjet për zhvillimin e lidhjeve ndërmjet profesionistëve vendorë dhe ndërkombëtarë.

“Redaksitë dhe disa kurse afatshkurtëra ishin edukimi i vetëm gazetaresk që kishim në dispozicion gjatë viteve të 70-ta,” tha Zenun Çelaj, duke folur për rëndësinë e IMK-së. “Ky institucion edukativ do të kontribuojë në krijimin e një dialogu më demokratik me dobi të ndërsjellë ndërmjet komuniteteve të ndryshme etnike, përmes mjeteve të mediave bashkëkohore,” shtoi ai.

## Statusi aktual

Instituti i Medias të Kosovës është regjistruar si entitet ligjor joprofitabil më 27 tetor 2005. Sikur shumë institute të medias në regjion, shumica prej të cilave ishin themeluar me ndihmën e Shkollës Daneze të Gazetarisë edhe IMK-së do t'i duhet të punojë shumë që të bëhet i vetqëndrueshëm.

Misioni i OSBE-së do t'i sigurojë fondet në mënyrë që të ndihmojë fillimin e funksionimit të institutit në vitin 2006. Për t'i

zvogëluar shpenzimet e konsulentëve, IMK-ja mëton të ketë hapsirë të përbashkët me Institutin Kosovar për Gazetari dhe Komunikime (KIJAC), që është themeluar si shkollë e gazetarisë me ndihmën e qeverisë norvegjeze, dhe që siguron shkallë magistrature në gazetari dhe shërben si institucion për edukim para fillimit të karrierës.

IMK-ja dhe KIJAC tani e mbushin zbrazëtirën që ka ekzistuar për disa vite me radhë në ndërtimin e institucioneve të medias.

## Çështjet e qëndrueshmërisë

Pas takimeve të para të ekipit të IMK-së me përfaqësuesit e komunitetit të donatorëve, disa agjenci shfaqën interesimin e tyre për ta përkrahur IMK-në. Megjithatë, ndërtimi i institucionit të IMK-së ka nevojë për një grup donatorësh thelbësorë të cilët do ta mbështetnin IMK-në për një periudhë prej 3 viteve, që janë të domosdoshme për konsolidimin e tij të plotë.

Në ndërkohë, IMK-ja do të zhvillojë projekte dhe programe për t'u vetfinancuar. Aq më shumë, kryesuesi i bordit të IMK-së, Agron Bajrami, që njëherit është edhe kryeredaktor i të së përditshmes Koha Ditore, ka zhvilluar një skemë strategjike financiare që ndërthet kontributet e vet mediave. Megjithatë, duke pasur parasysh gjendjen e vështirë financiare të medias në Kosovë, nuk do të ketë edhe aq shumë mundësi që ato të japin kontribut të rëndësishëm për punën e IMK-së.

Në këtë aspekt z.Çelaj tha: “Themeluesit e institutit të medias kosovare, do ta kenë të vështirë t'i krijojnë kushte normale për veprim IMK-së. Megjithatë, shpresoj se pas konsolidimit të tyre profesional dhe financiar, ato do të shohin interesin që të investojnë në favor të ngritjes së tyre profesionale përmes IMK-së. Besoj se investimet në aftësimin profesional të gazetarëve luajnë një rol të rëndësishëm për zhvillimin e Kosovës dhe rajonit dhe posaqërisht në krijimin e një ambienti demokratik dhe tolerant që u shërben interesave të të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë sonë”.

Përveç që do t'ju shërbejë qëllimeve të zhvillimit profesional, nga Instituti i Medias të Kosovës gjithashtu pritet që të bëhet një partner i rëndësishëm në përpjekjet për zhvillimin e medias në kuptim të gjerë. Nga instituti pritet që të zhvillojë hulumtime dhe analiza të situatës së medias dhe të vlerësojë nevojën për përmirësim në të ardhmen. Këto lloj analizash deri më tani është dashur të zhvillohen nga organizatat ndërkombëtare në Kosovë e posaqërisht nga OSBE-ja.



# KOSMA si agjencion lajmesh

Pas përfundimit të konfliktit elementare nga mediat. Du□ nga vendi në gjuhën e kom□

Kosovën, duke ofruar një shërbim të rëndësishëm për grupe të ndryshme qytetarësh që jetojnë këtu

Hasan Sopa, OSBE

Rrjeti informativ KOSMA është njëri prej këtyre shërbimeve që me sukses ofron program në gjuhën serbe për më Tepër se një vit. I financuar nga një grant i Agjencionit Evropian për Rindërtim (AER) në vitin 2001, rrjeti u ka mundësuar më tepër se 30 radiostacioneve që të ofrojnë lajme dhe informata në gjuhën serbe për dëgjuesit e tyre.

OSBE-ja si organizatë përgjegjëse për themelimin e Rrjetit KOSMA me ndihmën e partnerëve lokal, morri përgjegjësinë për zhvillimin e mediave të ndryshme dhe të vetëqëndrueshme në Kosovë. Duhet përmendur se nevoja për themelimin e Rrjetit KOSMA doli pikrisht në kohën e zgjedhjeve.

## Programin e parë e transmetoi 'Radio Graçanica'

"Komuniteti ndërkombëtarë vërejti se komunitet serb në enklava i mungonte informimi i duhur rreth zgjedhjeve të para në nivel të Kosovës", thotë Zhenet Mujiq, zyrtare e lartë për lirinë e mediave. Me themelimin e Rrjetit të radiove në gjuhën serbe, Misioni i OSBE-së shpresonte të ndihmonte në kapërcimin e problemit për shpërndarjen e informatave mbi zgjedhjet në gjuhën serbe.

Sipas Mujiqit, Rjeti KOSMA ishte një projekt sfidues ku janë nevojë të mëse tri vite përgaditje teknike. "Eshtë inicuar në janar 2002 dhe është lansuar në fund të vitit 2002 dhe fillimi i vitit 2003, kur edhe ka filluar procesi i organizimit dhe trajnimit të kuadrove." Emisioni i parë që u mundësua nga KOSMA dhe u transmetua nga 'Radio Graçanica' është emitue drejtpërdrejt më 20 shtator 2004, dhe për herë të parë pas pesë viteve një radioprogram në gjuhën serbe u emitua në gjithë territorin e Kosovës.

## Mungesa e programit informativ dhe gazetarëve profesional

Para kësaj date, shumë nga radiostacionet e komuniteteve të pakicave etnike janë ballafaquar pakashumë me të njëjtin problem, mungesën e informimit të duhur. "Shumë pak nga këto radiostacione kanë përgaditë program të tyre," thotë Mujiq. "Ata kryesisht emitojnë lajme dhe informacione nga Beogradi, kështu që jo vetëm është anashkaluar raportimi i ngjarjeve nga Kosova, por gjithashtu i'u është dhënë peshë raportimeve me fokus nga Beogradi". Një pjesë e problemit qëndron edhe në faktin se shumë nga këto radiostacione kishin mungesë të gazetarëve profesionist që do të mund të



Zhenet Mujiq zyrtare e lartë e Misionit të OSBE-së për zhvillimin dhe lirinë e mediave.

përgadisin lajme objektive nga burime të pavarura, si dhe t'i përgjigjeshin një standardi të lartë teknik dhe gazetaresk.

Qëllimi i Rrjetit KOSMA ishte krijimi i një rrjeti prej 27 radiostacioneve ekzistuese në gjuhën serbe të vendosura nëpër enklava serbe në tërë Kosovën. Znj. Mujiq shpjegon, "Eshtë vlerësuar se 80% e serbëve të Kosovës do të kishin qasje në radiostacionet e rrjetit". Këto radiostacione janë të ndara në dy grupe: grupi primarë me pesë radiostacione qëndrore me mundësi pranimit dhe dërgimi të të dhanavë; dhe grupi sekondarë me disa radiostacione më të vogla vetëm me mundësi transmetimi të materialeve.

## Një Radiostacion impresiv

Radioprogrami i Rrjetit KOSMA përgaditet në pesë radiostacionet primare të cilët e ndajnë përgjegjësinë e përgaditjes së programit në baza jvovore. "Çdo javë radiostacioni përgjegjës mbledhë të dhëna nga radiostacionet e tjera të rrjetit, si dokumentarë, lajme dhe informata të tjera që janë të rëndësishme dhe kanë të bëjnë me jetën e përditshme në Kosovë", thotë Mujiq. "Kjo është diçka që u ka munguar në të kaluren" si pas saj.

Programi informativ prej 30 minutave është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë ofron lajme nga vendi, ndërsa pjesa e dytë ofronë program dokumentar. "Shumë njerëz nëpër enklava nuk kishin as më të voglën ide se çka po ndodhte për rreth tyre e lere më në pjesët tjera të Kosovës. Kjo veçanërisht kishte të bënte me pakicën serbe, lëvizja e të cilëve ka qenë e kufizuar nëpër enklava", thekson Mujiq.

Sa i përket ofrimit të informative cilësore, radiostacioni më impresiv është Radio Gorazhdevac, thotë Mujiq. "Eshtë një radiostacion i vogël por me personel të përkushtuar dhe sipas mendimit tim ka një program shumë të mirë edhe përkundër faktit se operon në kushte shumë të vështira".

## KOSMA shqyrton anëtarësinë

Edhe për kundër kësaj, disa radiostacione, bile edhe në mesin e atyre primare kanë problem themelor me rekrutimin e gazetarëve cilësorë. "Njerëzit largohen në mënyrë konstante dhe kjo ndikon edhe në cilësinë e programit", shpjegon Mujiq.

Një problem tjetër me të cilin Rrjeti KOSMA ballafaqohet është se disa radiostacione së fundi kanë vendosur të shkëputen nga rrjeti thotë Mujiq. "Radio Graçanica për shembull nuk ka dëshiruar të transmetoj dokumentarë dhe lajme me përmbajtje 'shumetnike'. Ata friksoheshin se mos i humbnin dëgjuesin, të cilët sipas tyre, nuk janë mësuar të ndëgjojnë tregime me përmbajtje shumetnike dhe që shtjellojnë tematika për shqiptarët e Kosovës". Duke marrë këtë parasysh, bordi drejtues i Rrjetit KOSMA ka bërë shqyrtimin e anëtarësisë së vetë, me vetëm 12 apo 15 radiostacione që do të mbetën pjesë e rrjetit në një periudhë afatgjatë.

Bazuar në përvojën e kohës, dhe mundësinë e vetëqëndrueshmerisë së mediave në Kosovë në tërësi, znj. Mujiq mendon se të gjitha radiostacionet përfshirë këtu edhe Rrjetin KOSMA, duhet të mendojnë në bërjen e çdo programi interesant në mënyrë që të përfitojnë nga sfera e reklamës. "Ata kryesisht duhet t'i përshtatin strukturave që ekzistojnë në vendet perendimore, ku faktikisht mund të bëhet vlerësimi i çdo programi në aspektin e përfitimeve dhe humbjeve. Kjo duhet të ndodhe edhe këtu", mendon Mujiq.

Përkundër ndikimit që mund të ketë vetëqëndrueshmeria, Rrjeti KOSMA mëton ta ruaj statusin e vetë si një shërbim i rëndësishëm dhe të evoluojë në një agjencion lajmesh. Duke dëshmuar shtrirjen e saj të gjërë, programi i Rrjetit KOSMA nuk është i njohur dhe nuk dëgjohet vetëm në Kosovo, por ritransmetohet edhe në disa pjesë të Herzegovinës dhe Malit të Zi. Radiostacionet në Herzegovinë dhe Mal të Zi e marrin programin e Rrjetit KOSMA nga faja e internetit të njërit prej pesë radiostacioneve primare dhe mandej e ritransmetojnë për dëgjuesit e tyre. "Në një farë mënyre, Rrjeti KOSMA në të ardhmën mund të veproj si agjencion lajmesh i mirëfilltë", përfundon Mujiq.

# Udhëzues për policinë dhe gazetarët

Edita Buçaj, OSBE

Raporti në mes të gazetarëve dhe policisë shpesh mund të jetë i tendosur. Përderisa njëri profesion është nën presion të raportimit të ngjarjeve nga ora në orë, tjetrës i duhet që të jetë e kujdesshme dhe e matur, me qëllim të ndalimit të kriminelëve dhe sjelljes së tyre para drejtësisë.

Është e natyrshme që zbatuesit e ligjit dhe reporterët të jenë të parët në vendin e ngjarjes të një incidenti. Për arsye se axhendat e tyre nganjëherë janë kontradiktore, në vend se të punojnë së bashku, ata shpesh bëhen objekt i dyshimit dhe rivalitetit të padëshiruar ndaj njëri-tjetrit. Duke pasur parasysh këtë problematikë, Misioni i OSBE-së në Kosovë së fundi ka publikuar një udhëzues xhapi, me qëllim të parandalimit të mosmarrëveshjeve dhe keqkuptimeve në mes të dy grupeve.

Udhëzuesi shërben si mjet i shpejtë referimi, pasi ofron këshilla në tetë fusha të marra nga ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Kosovë. Për më tepër, zyrtarëve të policisë dhe gazetarëve u ipen ide se si të sillen në

këto situata, duke ofruar shembuj praktik rreth asaj se si të përmirësohet bashkëpunimi në raportimin e krimit dhe hetimeve në të njëjtën kohë.

Ky tekst, që është në përputhje me praktikën më të mira evropiane, mëton të ndryshojë metodën e raportimit të gazetave, radiove dhe televizioneve pa u konsultuar me policinë. Ai poashtu ka për qëllim që të inkurajojë zyrtarët e policisë që të punojnë me gazetarët në të mirë të rendit publik dhe kërksave të qytetarëve të zakonshëm për lajme dhe informata.

Hartimi i këtij udhëzuesi nga ana e OSBE-së, mandati i së cilës është ngritja e aftësiwe profesionale, do të duhej të inkurajonte zhvillimin e një raporti të shëndoshë të komunikimit të hapur në mes të policisë dhe mediave. Ky proces i dyanshëm padyshim do të sillte rezultate në lëminë e sundimit të ligjit. Fundja, të dy palët, policia dhe mediat, kanë një qëllim të përbashkët, që të punojnë për të vërtetën dhe drejtësinë.



Misioni i OSBE-së ka organizuar disa sesione dhe trajnime gjatë vitit të kaluar për të ndihmuar bashkëpunimin në mes të gazetarëve dhe policisë.

# Skeçet karakterizojnë sezonën e re të Rrugës Sezam

Gatë një vit pas ardhjes në Kosovë, Rrugja Sezam, një program i famshëm botërorë për fëmijë, do të vazhdojë të shfaqet edhe në vitin 2006 me 26 skeçe të bëra në Kosovë. Edhe një seri prej 26 skeçeve të reja do t'i shtohet epizodave që ishin bërë për fazën e parë.

Chris Cychmanick, OSBE

Transmetimi i edicionit të epizodave të Rrugës Sezam në Kosovë, që është sponsoruar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, UNICEF-i dhe USAID-i, ka filluar në dhjetor të vitit 2004. Ky program, që gërsheton argëtimin dhe mësimin duke dhënë shembuj për tolerancën dhe respektin, është bërë në gjuhën shqipe dhe serbe. Numri i epizodave që janë shfaqur gjatë një viti është 52.

Skeçet e përgaditura në vend kanë përmbajtje origjinale që tregojnë jetën e përditshme të fëmijëve kosovarë.

Ato përmbajnë tituj siç janë: "ecja e gjatë për në shkollë" dhe "kjo është familja ime" si dhe paraqesin valle ose muzikë tradicionale, vizita tek dentisti, një fëmij i verbër shqiptar duke e mësuar motrën e tij t'i bie pianos, fëmijët e komunitetit romë duke festuar ardhjen e pranverës si dhe të rinjët serbë duke u argëtuar në një shfaqje kukullash.

Secili skeç është dërguar në "Seminarin e Rrugës Sezam", regjisorët e të cilit janë në New York. Ata kanë analizuar çdo sekuençë dhe deklaratë të fëmijëve të Kosovës si dhe sa autentike kanë qenë skenaret. Qëllimi kryesor i "Rrugës Sezam" është që fëmijët t'i kuptojnë porositë e filmit si dhe të identifikojnë vetvetën me përmbajtjen e tij dhe të mësojnë nga ai.

Shpresa Mulliqi, punëtore e Misionit të OSBE-së dhe nënë e tre fëmijëve, thotë se

fëmijët e saj mezi presin të shikojnë këtë program. "Fëmijët e mi kënaqen me këtë program në çdo gjuhë. Ata janë të fascionuar që shohin fëmijët me kultura tjera. Ata e kuptojnë se janë të njëjtë si ata, këngët dhe filmat janë të njëjtë dhe intersat i kanë të përbashkët. Me fjalë të tjera, ata çuditën se si nuk shoqërohen me këta djemë dhe vajza", thotë

Mulliqi. Ajo shtoi se, "Këtu, prindërit, mardje, shohin mirësinë dhe pasurinë kulturore të Kosovës".

Faza e re e Rrugës Sezam premton të ndërtojë një bazë që do t'i mësojë fëmijët për rëndësinë e vlerave thelbësore gjatë viteve të tyre delikate.



Emitimi i 52 serive 'Rrugës Sezam' ka filluar në dhjetor të vitit 2004. Fëmijët e Kosovës do të kenë kënaqësinë t'i ndjekin këto programe javore që nga fillimi i dhjetorit të vitit 2005.



# Zyra e OSBE-se Lipjan: Welcome - Mirë se vini - Dobrodošli!

Artikujt në vijim japin një depërtim të thellë në punën e zyrës së OSBE-së në Lipjan dhe në zonën e përgjegjësisë nga të tri komunat që mbulon; Lipjan, Shtime dhe Glogovc.

**Artikujt e shkruar nga: Edit Kovacs, Lauras Oseku, Vardon Hoxha, Mirdita Retkoceri, Berat Reçica, Predrag Rašić, Vladan Trifić/OSBE**

Zyra e OSBE-së në Lipjan është e vendosur në një zonë që shpesh herë i është referuar si një 'Kosovë e vogël'. Komunitetet serbë, romë, ashkali, kroatë dhe boshnjakë të Kosovës bashkëjetojnë me shumicën shqiptare të Kosovës, në kuptimin e plotë të fjalës.

Sipas drejtoreshës së zyrës, Edit Kovacs, kjo është arsyeja kryesore që programi i Misionit për Ekspertët për të Drejtat e Njeriut për herë të parë është eksperimentuar pikërisht në komunën e Lipjanit. "Programi ka për qëllim t'i ofrojë administratës komunale një ekspertizë për të drejtat e njeriut dhe të sigurojë se legjislacioni komunal është në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe në veçanti me standardet evropiane të të drejtave të njeriut", thotë ajo dhe shton: "Këtu ka qenë një terren i përshtatshëm për këtë gjë". Ky program shpejtë është zgjeruar edhe në komunat Glogovc dhe Shtime.

Veç kësaj, edhe zyra e njësitit për demokratizim mbështetë komunat e lartë përmendura. Monitoron punën e tyre dhe sugjeron këshilla dhe programe për ngritje profesionale. "Këtu gjithashtu ekziston një terren i përshtatshëm edhe për këto aktivitete" shton Kovacs.

Në fazën e ristrukturimit të ardhshëm në mes të UNMIK-ut dhe OSBE-së, Kovacs shpreson

që lidhjet në mes të OSBE-së dhe komunave të bëhen edhe më të forta. OSBE-ja pret që të formojë grupet monitoruese në çdo komunë nga 30 sa ka Kosova. "Grupet për të drejtat e njeriut dhe zyrtarë e OSBE-së për demokratizim do bashkëpunojnë ngushtë me homologët e PISG-së në baza ditore. Të dyja palët, si zyra jonë po ashtu edhe udhëheqësia komunale kanë mirëpritur këtë dhe mezi presin të filloj implementimi e këtij projekti që parashihet me fillim të vitit të ardhshëm", tregon Kovacs, dhe shton: "Si rrjedhojë Lipjani është zgjedhur që të jetë ndër katër pilot komunat në të cilat do praktikohet për herë të parë kjo qasje".

Siç e kemi situatën në Kosovë, çdo komunë dallon nga tjetra. Ato reflektojnë nivele të ndryshme të zhvillimit, indikator demografik, përbërje etnike dhe realitete sociale të ndryshme. Sikur që shumica e çështjeve dhe sfidave ndryshojnë, gjithashtu edhe ngjashmëritë mund të vërehen, p.sh. problemi i përbashkët i punësimit dhe mungesa e perspektivës ekonomike. "OSBE, me ndihmën e të gjithë partnerëve lokal dhe ndërkombëtarë në teren do të përpiqet të kuptoj thellësisht kompleksin e ambientit dhe t'i përgjigjet nevojave të komuniteteve", shpjegon Kovacs.

Ajo thekson se të gjitha projektet e përmendura të OSBE-së përmes artikujve të mëposhtëm i adresojnë këto shqetësime duke ndërtuar ura në mes të komuniteteve dhe duke ofruar angazhim aktiv të nivelit bazë të shoqërisë në ekzekutimin e procesit të vendimarrjes.



*Edit Kovacs udhëheq zyrën e OSBE-së në Lipjan që nga vera e vitit 2003*

## Glogovci – një përjashtim në ligj

"Ne kemi arritur rezultate të mira në vlerësimin e standardave. Kemi marrë vërejtje vetëm sa i përket gjuhës, e cila është e pranueshme, pasi që ne jemi një 'përjashtim' sepse nuk kemi minoritete këtu", thotë Ibrahim Hajdari, kordinatori i komunës së Glogovcit për standarde. Në fakt, sipas standardave vlerësuese, të përpiluara nga Ministria e pushtetit lokal, në Glogovc janë vetëm dy çështje 'të nxehta': mospërshtatshmëria me politikën gjuhësore dhe pjesëmarrja e qytetarëve në procesin vendimarrës.

### Transparenca si prioritet

Sa i përket sfidës së parë, zyrtarët e komunës kanë mendim të njetë si edhe Kordinatori i Komunës për Standarde. Sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve, Ragip Gjoshi, zyrtar i komunës për informim, thotë: "Transparenca dhe përgjegjshmëria janë pa asnjë dyshim bazat e demokracisë.

Komuna jonë ka transparencën si prioritet të saj".

Gjoshi numroi disa të arritura, siç janë takimet e rregullta me qytetarë, bordi i komunës, si dhe revista 'Spektri', një buletini i kuventit komunal që financohet nga OSBE-ja, si formë e mbështetjes për punën e zyrtarëve të komunës për informim. "Përmes buletinit 'Spektri', ne mëtojmë që të ndajmë këndvështrimet si dhe informatat për aktivitete të komunës. Ne gjithashtu mendojmë se kur ta japim informacionin nuk kemi të drejtë që të gjykojmë se çka është mirë e çka keq. Detyra e jonë është që të informojmë opinionin", shtoi Gjoshi.

### Mbështetja dhe këshillat e OSBE-së janë të çmueshme

Kryetari i Kuvendit Komunal të Glogovcit, Gani Sylaj, është shumë mirënjohës për ndihmën dhe këshillat që OSBE-ja i ka dhënë për përbushjen e standardave. "Ne

kemi qenë komuna e parë që e ka dënuar publikisht dëmtimin e shenjave rrugore në gjuhën serbe dhe ne kemi reaguar me kohë. Shenjat janë rregulluar menjëherë", thotë Sylaj.

Si aktivitetet me domethënje të kësaj komune, ai përmendi parkun industrial në Glogovc. "Ne fituam një grant prej 3.1 milion eurosh nga Qeveria pasi fituam në një konkurrencë të nivelit qendror". Z. Sylaj gjithashtu përmendi edhe një varg projektesh tjera të financuara nga donatorët, siç janë Banka Botërore dhe Instituti Riinvest. "Me këtë lloj të asistencës financiare, komuna i'a ka dalë që të përpilojë një strategji për zhvillim lokal ekonomik," thotë ai.

Kur e pyetëm për probleme, ai u përgjigj shpejtë, "Mungesa e ekspertizës për bërjen e ligjit lokal si dhe 'mënyra e centralizuar e qeverisjes' shkaktojnë probleme, sidomos në sferën e inspektimit në komunë.

# OSBE-ja ndihmon integrimin në Magurë

Raportet në mes të shqiptarëve, ashkalinjëve, serbëve dhe romëve të Kosovës në fshatin Magurë të komunës së Lipjanit, ku jetojnë komunitete të ndryshme, kanë qenë miqësore edhe para vitit 1999, kur mëse 1460 minororë siguronin bukën e gojës nga miniera e Magurës.

Rahim Rexhepi, ashkali nga fshati Magurë dhe koordinatori i mësimintenziv, një projekt i përbashkët i Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe Ministrisë së Arësimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i cili ndihmon përfshirjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptas në shkollim të rregullt, thotë se këto raporte janë të kënaqshme përsëri. Sfida kryesore me të cilën përballlet fshati është papunësia dhe mungesa e arësimit më perspective.

## Procesi i kthimit

Procesi i kthimit në Magurë ka filluar në mes të vitit 2002, me kthimin e njëmbëdhjetë familjeve të para të komunitetit ashkali. Sipas udhëheqësit të këtij komuniteti Hasan Avdullahut, 35 familje të kthyra jetojnë aty edhe sot.

Mirëpo jo të gjitha familjet kishin kurajo të qëndronin. Rreth shtatë familje kanë vendos të largohen gjatë katër viteve të fundit kryesisht për mungesë të perspektives ekonomike.

Për ta ndihmuar Kuvendin Komunal të Lipjanit në procesin e kthimit të familjeve rome dhe ashkali nga kampi i Plementinës në fshatin Magurë për mes skemës për strehim social, zyra e OSBE-së inicoi një trajnim të mirëpritur në fushën e biznesit me qëllim që t'i ndihmohet popullatës me mundësi më të vogla për zhvillim ekonomik. Trajnimi përfshinte ngritjen e aftësive për biznes dhe që nga gushti i këtij viti e deri më sot rreth 250 individ kanë përfituar nga këto trajnime.

## Integrimi shoqëror

Riintegrimi i komunitetit lokal nuk është edhe aq i lehtë shpjegon Lulzim Qerimi,

ashkali dhe njëherit përfitues i tranimit të ofruar nga OSBE-ja. Profesionisti i tij si elektrikist ka qenë element thelbësorë për integrimin e t'i në komunitetin e Magurës. "Ne si komunitet nuk mund të integrohemi nëse nuk krijojmë kontakte me komunitetet tjera. Deri më tani kam punuar në më shumë se 50 apo 60% të familjeve të Magurës. Falë profesionit tim shumica e bashkëfshatarëve më njohin dhe më respektojnë kur më takojnë në rrugë apo kudo", thotë ai. "Kontaktet dhe bashkëveprimi janë arsyt kryesore që më bënë të mendoj për hapjen e një qendre shumetnike për të rinjtë, e cila do t'i tërhiqte të rinjtë ashkali, romë dhe shqiptarë nga të gjitha fshatrat për rreth".

## Nevoja për arsimim

Qendra shumetnike për të rinjtë nuk është iniciativa e vetëm e Qerimit. Me mbështetjen e OSBE-së ai tashmë ka themeluar një OJQ të quajtur 'Ashkan'.

Gjersa objektivi primar i OJQ-së 'Ashkan' është duke u dal në ndihmë të gjitha komuniteteve me ndihma humanitare, kryesisht me ushqime dhe veshmbathje, sikurse edhe me kurse themelore për kompjuter dhe gjuhë të huaja. Ata përpiqen të arrijnë një zhvillim të qëndrueshëm me anë të arsimimit të duhur.

Sipas z. Qerimi, i cili nuk ka ditur ta përdor kompjuterin edhe vetë deri në themelimin e OJQ-së 'Ashkan', komuniteti ashkali në aspektin e arsimimit ka stangu për 15 vite. Kjo ka zgjatë deri në vitin 2003 kur një grup fëmijësh nga komuniteti ashkali u mirëpritën nga shkolla fillore 'Jeronim de Rada' në Magurë.

Ata tani shpresojnë të dërgojnë edhe shumë fëmijë të tjerë në shkollë, por shumë nga fëmijët e tyre kanë mbetur mbrapa në arsim të cilët nuk kanë mundur ta vazhdojnë me bashkëmoshatarët e tyre. Për t'iu përgjigjur kësaj ngecje Misioni i OSBE-së dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në tetor të vitit 2004 ka filluar me implementimin e një programi të Mësimintenziv i përshtatur që t'i ndihmojë fëmijët romë, ashkali dhe egjiptas të kyqen në shkollimin e rregullt.

Gjerë më sot mëse 70 nxënës nga fshatrat Magurë, Mostinë, Hallaq i Vogël, Dobrajë e Vogël dhe Vrellë kanë vijuar mësimin intenziv. Njëzet orë mësimi në javë janë mbajtur nga mësimdhënës shqiptarë në klasë të përzira etnike ku nxënësit varionin nga mosha 8 deri në 17 vjeqare me vetëm një përjashtim të njërit me moshë 25 vjeqare. Që nga fillimi i vitit shkollor 2005-2006, shumicës së këtyre nxënësve u është mundur të regjistrohen në klasët përkatëse të grupmoshave të tyre.

## Kërkohet dituri për të dhënë dituri

Rahim Rexhepi, një ashkali nga Magura i cili ka vetëm edhe një vit për të diplomuar në fakultetin juridik, bënë koordinimin e mësimintenziv në nivel lokal. I martuar me shtatë fëmijë dëshiron të sigurojë se arsimiti u ofrohet të gjithëve dhe plotësisht i mbështetë aktivitetet arsimore të ndërmarrura nga OJQ-ja 'Ashkan'. Ai gjithashtu thotë se ashkalinjtë me një arsimim të duhur duhet tua përcjellin njohurit e tyre edhe të tjerëve pa marrë parasysh përkatësin etnike. "Pikrish për këtë unë e vlerësoj lartë mësimintenziv", thotë ai.

## Problemet vazhdojnë

Por problemet ende vazhdojnë. Avdullahu thotë se komuniteti i tij është shkëputur nga furnizimi me rrymë elektrike që nga shtatori i vitit 2005 dhe ende nuk është gjetë ndonjë zgjidhje. "Ne kemi njoftuar kuvendin komunal për këtë çështje por ende nuk kemi marrë përgjigje", thotë ai. Ai gjithashtu thekson se ashkalinjëve nuk u ofrohen mundësi të barabarta punësimi. "Është vështirë të gesh edhe pastrues nga komuniteti ynë të punësuar në ndonjë klinikë shëndetësore", shprehet ai dhe thotë: "Ne na nevojitet punë dhe perspektivë për një të ardhme më të mirë".

Pritja e gjatë e privatizimit të minjerës në Magurë, që parashihet të ndodhë në fillim të vitit 2006, mund të jetë një shansë e mirë. Ka shpresa të mëdha se hapja e minjerës do të ndikonte në përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe jetës së të gjithë atyre që jetojnë në këtë fshat.



35 Familje të Ashkalinjëve tani jetojnë në fshatin Magurë.



# Integrimi përmes syrit të të rinjve

Në tetor të viti 2005, anëtarët e Kuvendit Rinor të komunës së Lipjanit kanë implementuar projektin e tyre të fundit. Ata kanë paraqitur Standardet për Kosovën në një mënyrë kreative dhe në një mënyrë të bukur. I financuar nga OSBE dhe i përkrahur nga KFOR-i Irlandez dhe IPVQ, Parada për Standardet u ka dhënë njerëzve një mundësi që të shohin se si të rinjtë i kuptojnë Standardet, veçanërisht të atë të Lirisë së Lëvizjes

## Kuvendi Rinor - fillimi

Kuvendi Rinor i komunës së Lipjanit është themeluar në qershor të vitit 2003 si pjesë e projektit të OSBE-së "Kuvendit Rinore për zhvillim të komunitetit". Kjo i'u ofron të rinjve një mundësi që të përdorin vullnetin e tyre për pjesëmarrje në vendimarrje që kanë të bëjnë me çështjet e rinisë brenda strukturave të qeverisjes lokale.

Kuvendi Rinor bënë punë të ngjashme me punën e Kuvendit Komunal. Në Lipjan është një forum prej 25 të rinjve të të gjitha komuniteteve që ndjehen të lirë për të shprehur mendimet e tyre, interesimin dhe të marrin vendime në një mënyrë transparente dhe demokratike.

Përmes programit, të rinjtë marrin trajnime në një varg temash të ndryshme. Ata mësojnë për demokracinë, për pjesëmarrje në vendimarrje dhe në implementimin e projekteve që i adresojnë në bazë të nevojave të tyre dhe të komunitetit të tyre.

Kuvendi Rinor i Lipjanit ka implementuar disa projekte të ndryshme. Ata kanë arritur që të menaxhojnë një ndërtim të një fushe basketbollit në Lipjan, afër Qendrës Rinore Sportive. Ata gjithashtu kanë organizuar një turnir sporti dhe kanë xhiruar një film dokumentar rreth lirisë së lëvizjes. Projekti i tyre i fundit ka qenë Parada për Standardet që ka sjellë mesazhin për të gjithë se Standardet për Kosovën janë të rëndësishme edhe për të rinjtë.

## Trajnimi – ngritja e vetëdijes – rrjeti

"Si anëtarë të Kuvendit Rinor, ne kemi marrë pjesë në një numër trajnimesh, të cilat na kanë ndihmuar që të ndërtojmë një grup të mirë dhe na kanë dhënë njohuri të dobishme për punën tonë dhe për implementimin e projekteve.

Ne gjithashtu kemi marrë pjesë në trajnime të ndryshme në kampet e organizuara në Brezovicë dhe në Mal të Zi, ku kemi pasur mundësi që të takohemi, të formojmë rrjete dhe të punojmë me të rinjtë e Kuvendeve të tjera Rinore nga komunat e Kosovës", thotë Bujar Bytyqi, anëtar i Kuvendit Rinor në Lipjan.

"Kuvendi Rinor do të vazhdojë me aktivitetet e veta edhe vitin e ardhshëm me përkrahjen financiare të OSBE-së. Shpresojmë se deri në fund të vitit të ardhshëm Kuvendet do të janë të zhvilluara njafte për të lehtësuar transformimin e tyre në OJQ që mund të ngrisë fonde dhe të sigurojë në mënyrë ndërkombëtare qëndrueshmërinë për të ardhmen edhe pas OSBE-së", thotë koordinatori i projektit të Kuvendit Rinor, Mathju Minns.

## Të arriturat dhe sfidat

"Së pari mendoja se pjesëmarrje në mbledhjet dhe aktivitetet e Kuvendit Rinor është një humbje kohe por pasi që kam parë rezultatit e punës sonë unë kam filluar të besoj të kundërtën", thotë Mirlinda Jashanica, një

anëtare e Kuvendit Rinor.

Një pikëpamje e njëjtë është ndarë edhe me kryetaren e Kuvendit Rinor, Albulena Bre-stovci. "Pikënisja ime ishte se Kuvendi Rinor është vetëm një trup tjetër politik për të dik-tuar të rinjtë, sikurse Kuvendet Komunale. Unë nuk e dua politikën, për këtë arsye, unë kurrë nuk kam menduar që të bëhem anëtarë e aq më pak kryetare. Por pas gjithë klësaj, tani unë mendoj shumë më ndryshe sepse kjo është një mundësi e mirë për të theme-luar kontakte të reja me të rinjtë në komu-nën time, në Kosovë dhe jashtë Kosovës. Kjo është gjithashtu mundësia më e mirë për të këmbyer përvojat tona në të gjitha sferat e jetës. Unë jam shumë e kënaqur që mundem të kontribuoj në Kuvendin Rinor dhe përmes kësaj t'i kontribuoj komunitetit tim, komu-nës sime dhe gjithë Kosovës".

Sidoqoftë, puna e Kuvendit Rinor nuk është gjithmonë pa pengesa dhe shpesh kjo reflek-ton realitetin e Kosovës. Një ndër sfidat më të mëdha është pajtueshmëria në mes komuniteteve etnike dhe kjo një ndër qëlli-met kryesore që Kuvendi Rinor dëshiron ta arrijë.



Parada për Standarde e organizuar nga Kuvendi Rinore e Lipjanit në tetor të vitit 2005, paraqiti Standardet në mënyrë të re dhe kreative.

# OSBE përkrah zhvillimin e bizneseve të vogla në vendet rurale

Edhe pse kanë kaluar gjashtë vite pas konfliktit, dikush mund të thotë se situata e përgjithshme në Kosovë është përmirësuar. Është shënuar përparim në shumë fusha, edhe pse në faza të ndryshme.

Me rritjen e efikasitetit të institucioneve demokratike, janë arritur zhvillime positive në jetën publike. Sidoçoftë, ekonomia posaçërisht në nivelin local, është në situatë të rëndë. Kalimi nga ekonomia e kontrolluar nga shteti, në një treg të hapur gjithmonë shoqërohet me sfida dhe vështirësi. Siç ndodh shpesh, pjesët rurale janë më së shumti të prekura.

## Papunësia, brenga më e madhe

Shtimja dhe Lipjani nuk dallojnë. Situata ekonomike është brenga e vetme më e rëndësishme në këto komuna. Papunësia e llogaritur arrin 70% dhe është potencialisht më e rritur tek komunitetet pakicë. "Zyra jonë i ka regjistruar 3,213 persona të papunë prej të cilëve 1,253 janë femra," thotë Zeqeria Sadriu, zyrtar për punësim në komunën e Shtimes.

Një qëndrim i ngjashëm është dhënë nga homologu i tij në komunën e Lipjanit, Ismet Gashi, i cili thotë se numri i përgjithshëm i të papunësuarve në komunën e tij arrinë 9,902 prej të cilëve 4,090 janë femra. Ata të dytë besojnë se shifrat nuk janë as afër shifrave të vërteta dhe dikush mund të vlerësojë se kjo mund të reflektoj mungesën e besimit të qytetarëve, në aftësinë e strukturave komunale të ballafaqohen me këto çështje.

Pas konsultimit me zyrtar të ndryshëm komunal, akterët kryesorë të të gjitha komuniteteve dhe OJQ-ve vendore, OSBE-ja zhvilloi një projekt "Ngritja e kapaciteteve për grupet e pafavorshme në pjesët rurale të Lipjanit dhe Shtimes." Qëllimi i këtij projekti i cili filloi me 1 tetor 2005 është kontributi mbi zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe për të siguruar përkrahjen komunale për projektet e bizneseve të vogla.

Më shumë se 170 persona, me prioritet femrave dhe popullatës prej vendeve rurale, që përfaqësojnë të gjitha komunitetet, janë duke marrë pjesë në seritë e sesioneve të trajnimit me qëllim të zhvillimit të njohurive dhe aftësive të duhura për të filluar një biznes të vogël. Çështjet si p.sh kryerja e një hulumtimi para se të fillohet një biznes, si të themelohet një biznes, si të shitet një produkt dhe si të mbahen të hyrat dhe shpenzimet e një biznesi, si të menaxhohet personeli dhe si të aplikohet për kredi biznesi, janë të gjitha tema që janë diskutuar gjatë pjesëve

të trajnimit që kishin për qëllim zhvillimin e aftësive praktike të biznesit.

## OJQ-të lokale partner implementues

Me qëllim të sigurimit të pronësisë dhe stabilitetit maksimal, janë zgjedhur veçmas OJQ-të vendore për të implemetuar projektet. 'Vizioni i të Rinjëve' dhe HandiKos-i, të dyja, OJQ me përvojë të lartë janë duke kryer aktivitetet në komunat e lartëpërmendura. Deri tash, trajnimet ishin të organizuara në Shtime, Lipjan dhe fshatin Vojnovc dhe mbi 90 pjesëmarrës i ndoqën ato.

Njëri nga trajnerët, Bekim Grainca, e përshkruan qasjen e tyre: "Ne jemi duke u mundar ta shfrytëzojmë një qasje praktike sa më

shumë që është e mundur. Ne dëshirojmë që pjesëmarrësit të jenë në gjendje të transferojnë nohurinë e fituar dhe ta praktikojnë ate në jetën e tyre të përditshme. Ne ende kemi kontakte të mira me pjesëmarrësit, dhe do të vazhdojmë ti ruajmë ato edhe në të ardhmen dhe do t'i përkrahim kur ata ballafaqohen me sfida të reja".

Koordinatori i projektit për komunën e Shtimes, Tafë Fazliu, nga HandiKos thotë se projekti është pranuar mirë nga të dyja palët, si nga pjesëmarrësit ashtu edhe nga zyrtarët e komunës pasi që po dëshmon si i përshtatëtshëm me jetën e tyre të përditshme në Kosovë. "Pjesëmarrësit po mësohen të bëjnë plane biznesi dhe t'i implemetojnë ato. Ata gjithashtu mësojnë si të aplikojnë për kredi biznesi në organizata të ndryshme për kredi," thotë Fazliu.



Projektet e OSBE-së për ngritjen profesionale të anëtarëve të grupeve të pakicave në Lipjan, përfshijnë edhe zhvillimin e shkathtësive praktike në biznes.



# Grackë e Vjetër: Një fillim i ri

Fshati Grackë e Vjetër daton nga fillimi i viteve të njëzeta. Ai ishte ndërtuar sipas planit të inxhinierëve rusë dhe ishte një prej fshatrave më të 'urbanizuar' të Kosovës. Konstruksioni i shtëpive të reja nuk e ka ndërruar bukurinë origjinale të fshatit. Fushat e gjelbërta përreth dhe shumë drunjë të gjelbërt krijojnë një pamje piktoreske. Shkolla fillore, e renovuar së fundi në qendër të fshatit dhe qendra e rinisë me një fushë të madhe futbollit si dhe fusha sportive aty afër i japin fshatit një pamje të freskët.

Kjo pamje ndërron shpejt pas bisedave të para me fshatarë. Trishtimi, pikëllimi dhe një e ardhme pa shpresë, është ajo çka ata rrëfejnë.

## Mungesa e mundësive për qytetarë

Që nga 1999, rreth 180 fshatarë e kanë lëshuar fshatin dhe pas trazirave të marsit 2004, edhe gjashtë familje tjera kanë ikur. Në ndërkohë, vetëm dy familje janë kthyer në fshat. Për banorët e këtij fshati mungesën e lëvizjes së lirë, izolimin me fshatrat tjera serbe në Kosovë dhe mungesa e perspektivës ekonomike janë arsyt kryesor që i shqetësojnë. Shifrat e punësimit janë tregues të kësaj gjendje: vetëm 11 njerëz janë të punësuar në shkollë dhe në ambulancën e fshatit, dy punojnë në SHPK dhe pesë janë punësuar si roje burgu.

Për më tepër, projektet e mëdha të realizuara nga donatorët ndërkombëtarë dhe nga IPVQ-të nuk arritën në fshat. Fshatarët ankohen se ata janë harruar nga të gjithë edhe përkundër daljes së lartë në votime në 2002, krahasuar me zonat tjera të banuara me serbë të Kosovës.

## Mbështetja e OSBE-së

Megjithatë, OSBE-ja e ka ndihmuar vazhdimisht këtë fshat. Para dy vitesh, kur orët e gjuhës angleze dhe ato për kompjutor organizoheshin në qendrën e rinisë në Lipjan, zyra e OSBE-së i zgjeroi aktivitetet e njejta në edhe në qendrën e rinisë në Grackë të Vjetër.

"I jam shumë mirënjohës OSBE-së për ndihmë dhe mbështetjen që i ka dhënë fshatit tonë", thotë Zoran Cirkoviq, udhëheqës i komunitetit dhe drejtor i qendrës së rinisë në Grackë të Vjetër. "Kemi pasur bashkëpunim të mirë gjatë tërë këtyre viteve dhe i kemi mbështetur të gjitha aktivitetet në këtë zonë. Atëherë kur ishte vështirë që serbët e Kosovës të marrin pjesë në regjistrim dhe zgjedhje, pjesëmarrja e fshatit tonë ishte 80%," shton ai.

OSBE-ja pranoi ta mbështesë shoqërinë tonë kulturore-artistike, në sigurimin e pajisjeve elementare për orët e vizatimit dhe të pikturës, seksionin e sportit, seksionin e letërsisë, pajisjen për ansamblin e vallëzimit

si dhe sigurimin e karrigave në sallën e kinemasë. Duke i'u referuar projektit të aprovuar së fundi, i financuar nga Qeveria Amerikane, udhëhequr nga Fondi për Mbështetjen e Komuniteteve Etnike (FQKE) pranë OSBE-së dhe i realizuar nga Qendra e Rinisë në Grackë të Vjetër, kishte për qëllim mbështetjen dhe revitalizimin kulturor dhe sportiv të jetës së rinisë në fshat. Zoran Cirkoviq shpreh mirënjohjen e tij: "Do ta shfrytëzoja këtë rast për t'i shprehur falënderim të posaqëm Edit Kovacit dhe Predrag Rasiqit për tërë ndihmën e tyre. Projekti do të jetë i rëndësishëm së madhe për njerëzit që kanë vendosur të qëndrojnë këtu. Kjo do ta përmirësojë kualitetin e jetës".

## Një hap gjigant për fshatin

"Çfarë ardhmërie kanë të rinjtë pas përfundimit të shkollës"? pyet profesoresha Mileva Peshiq. "Duke i parë të rinjtë tanë pa shpresë dhe të frikësuar, personeli i shkollës, me mbështetjen aktive të kryetarit të fshatit Zoran Cirkoviq, vendosi ta riaktivizojë

klubin tonë kulturor "Shën Sava". Duke i'u falenderuar Organizatës Ndërkombëtare për Migrim dhe KFOR-it finlandez, që e ndër-tuan qendrën e rinisë, ne tani kemi vend për t'i mbledhur të gjithë të rinjtë. Ne gjithashtu kemi organizuar një bibliotekë lëvizëse për t'i vizituar fshatrat e largëta," thotë ajo.

Këto aktivitete tani financohen edhe nga Ministria e Rinisë, Sport dhe Kulturë. Nepërmjet projektit të FQKE-së, OSBE-ja është duke e ndihmuar pajisjen e qendrës së rinisë me veshje për tavolina të tenisit, materiale për vizatim dhe pikturim, mjete folklorike për ansamblin dhe karriga për sallën e kinemasë.

"Ne të gjithë jemi të bindur se këto projekte do të ndihmojnë në krijimin e kushteve më të mira për rininë e fshatit. Gjithashtu shpresojmë që të kemi më shumë raste për bashkëpunim me komunitetet tjera, siç kemi pasur me rininë e Janjevës. Ne besojmë shumë se ka ardhur koha për integrim në shoqërinë kosovare, sepse më nuk është e mundur të jetohej ndarazi, konkludon Peshiq.



"Ne vërtetë besojmë se ka ardhur koha që ne të integrohemi në shoqërinë Kosovare", thotë Mileva Peshiq, arësimitare në shkollën fillore në fshatin Grackë e Vjetër.

# UZURPIMTĪ PROŅEMŠĪ HĪVAJ

“MŪKŠĪTĪŠĪ LĪVĪBĪSĪ”



**OSCE**  
MISSION IN MOSCOW